

## **Njoftim i rregullimit të pushimit mjekësor të të punësuarve të infektuar me COVID - 19 (Koronavirus) si dhe të punësuarve që janë në izolim për të parandaluar infeksionin**

Lidhur me pyetjet më të shpeshta nga njësitë rajonale, si dhe nga kompanitë se si të rregullohet e drejta e kompensimit të pagës gjatë ndalesës së përkohshme në punë të të punësuarve që kanë simptoma dhe janë të infektuar me COVID - 19 (Koronavirus), ndaj personave që janë në izolim për të parandaluar infeksionin, por janë asimptomatikë (përkatësisht nuk kanë shenja të sëmundjes) dhe janë diagnostikuar me COVID - 19 (Koronavirus) si dhe për persona të cilët janë në izolim (karantinë) për të parandaluar infeksionin, por nuk është konfirmuar se janë të infektuar me COVID - 19 (Koronavirus), Ju informojmë si më poshtë:

Në bazë të nenit 13 të Ligjit të Sigurimit Shëndetësor, e drejta e kompensimit të pagës gjatë ndalesës së përkohshme për punë për shkak të sëmundjes dhe lëndimit mund të ushtrohet vetëm nga personat e siguruar që janë të punësuar, në rast të:

1. Sëmundjes dhe lëndimit jashtë punës;
2. Lëndimit në punë dhe sëmundjes profesionale;
3. Trajtimit dhe ekzaminimit mjekësor;
4. Kujdesit të fëmijës së sëmurë deri në moshën tre vjeçare;
5. Kujdesit të një anëtari të sëmurë të familjes mbi moshën tre vjeçare, por maksimumi 30 ditë;
6. Mbështetjes së domosdoshme të një personi të sëmurë, i udhëzuar për ekzaminim ose trajtim jashtë vendbanimit;
7. Mirëmbajtjes së domosdoshme të fëmijës së sëmurë deri në moshën tre vjeçare, përderisa është në trajtim spitalor, por jo më shumë se 30 ditë;
8. Dhurimit vullnetar i gjakut, indeve ose organeve dhe
9. Kompensimit për të parandaluar infeksionin

### **1. Ushtrimi i së drejtës së pushimit mjekësor të të punësuarve që kanë simptoma dhe vuajnë nga COVID - 19 (Koronavirus)**

Të punësuarit që kanë simptoma dhe janë të infektuar me COVID - 19 (Koronavirus), do të ushtrojnë të drejtën e tyre të kompensimit të pagës gjatë ndalesës së përkohshme për punë në përputhje me nenin 13 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit të Sigurimit Shëndetësor, përkatësisht mjeku i përzgjedhur do të lëshojë Formular RNP në bazë të sëmundjes për të cilën kompensimi i pagës për 30 ditët e para të ndalesës për punë përcaktohet dhe paguhet nga punëdhënësi nga fondet e veta, ndërsa mbi 30 ditë nga Fondi.

Personat e siguruar që janë të sëmurë dhe kanë simptoma të COVID - 19, ndërsa monitorohen dhe trajtohen të izoluar në shtëpi, mjeku i zgjedhur mund t'u lëshojë pushim mjekësor deri në 20 ditë, pas mendimit paraprak të Komisionit Mjekësor të Shkallës së Parë, nëse nuk ka simptoma për 3 ditë rresht. Pushimi mjekësor për më shumë se 20 ditë vazhdon derisa nuk plotësohet kushti i 3 ditëve radhazi pa simptoma.

Personave të siguruar me COVID – 19, të cilët janë shtruar në spital, pas daljes nga spitali, mjeku i zgjedhur mund t’u lëshojë pushim mjekësor në përputhje me kriteret, pas mendimit paraprak të Komisionit Mjekësor të Shkallës së Parë.

## **2. Realizimi i të drejtës së pushimit mjekësor të të punësuarëve që nuk kanë simptoma por janë të infektuar nga COVID - 19 (Koronavirus)**

Të punësuarit që nuk kanë simptoma, por janë të infektuar nga COVID - 19 (Koronavirus) do të realizojnë të drejtën e tyre për kompensimin e pagës gjatë ndalesës së përkohëshme për punë në përputhje nën 13 paragrafi 1 pika 9 nga Ligji i Sigurimit Shëndetësor, përkatësisht mjeku i përzgjedhur do të lëshojë formular RNP, ***në bazë të izolimit në mënyrë që të prandalojë infeksionin***, për të cilin kompensimi i pagës për 30 ditët e para të ndalesës për punë përcaktohet dhe paguhet nga punëdhënësi nga fondet e veta, dhe mbi 30 ditë nga Fondi.

Të siguruarit e sëmurë nga COVID- 19, që nuk kanë simptoma, ose janë me pasqyrë të lehtë klinike për të cilët nuk duhet pushim mjekësor dhe monitorohen në kushte shtëpiake në izolim, mjeku i zgjedhur mund të lëshojë pushim mjekësor prej 10 ditësh,

**Shënim për pikën 1 paragrafi 2 dhe pikën 2 paragrafi 2:** Vërtetimi që i siguruari është shëruar (asimptomatik ose simptomatik përkatësisht sipas algoritmit) do të jepet (shënohet në sistem) nga epidemiologu nga Qendra përkatëse e shëndetit publik në bazë të të dhënave që hynë çdo ditë nga mjeku amë për personat e siguruar që po marrin trajtim në shtëpi. Kjo do të thotë që procesi është i automatizuar, dhe bazohet në të dhënat e mjekut amë, por a do të konsiderohet i siguruari si i shëruar, vendos epidemiologu.

Sipas kësaj shërbimi epidemiologjik krijon raport përmbledhës për pacientët e shëruar çdo ditë në excel me të dhënat për të njëjtit ,të cilat i dorëzojnë deri te ISSHSH-ja për lirim nga Vendimi për izolim të personave pozitivë, deri te MPB-ja për lirim nga vizita shtëpiake nga ana e personit të uniformuar dhe deri te FSHSRMV-ja në mënyrë që të realizojë të drejtën e të siguruarit për pushim mjekësor.

## **Realizimi i të drejtës për pushim mjekësor të të punësuarëve që janë në izolim (karantinë) për të parandaluar infeksionin sepse u kthyen nga vendet me rrezik ose ishin në kontakt me personat e sëmurë, por nuk është e konfirmuar se janë të infektuar me COVID -19 (Koronavirus)**

Të punësuarit që janë në izolim (karantinë) për të parandaluar infeksionin sepse u kthyen nga vendet me rrezik ose ishin në kontakt me personat e sëmurë por ata nuk janë të konfirmuar se janë të infektuar me COVID -19 (Koronavirus), mjeku i zgjedhur nuk jep pushim mjekësor.

I siguruari është në izolim në kushte shtëpiake (karantinë),në përputhje me aktvendimin nga ISSHSH-ja ku specifikohet periudha e vetë-izolimit.